



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0454**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim, Kryesueseduke vendosur sipas ankesës së OE AOME SH.P.K., kundër Njoftimit për kontratë, ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me dru për institucionet edukativo arsimore, bashkësit lokale, bibliotekat, AMF-të dhe nevojat tjera komunale.” me nr. të prokurimit: "616-24-4590-1-2-1", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 30.07.2024, mori këtë:

## Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e AOME SH.P.K., me nr. 2024/0454, e datës 27.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me dru për institucionet edukativo arsimore, bashkësit lokale, bibliotekat, AMF-të dhe nevojat tjera komunale.” me nr. të prokurimit: "616-24-4590-1-2-1", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Vërtetohet njoftimi për kontratë, i AK-së i lejohe të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 13.05.2024 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me dru për institucionet edukativo arsimore, bashkësit lokale, bibliotekat, AMF-të dhe nevojat tjera komunale.” me nr. të prokurimit: "616-24-4590-1-2-1".

Me 14.05.2024, OE AOME SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 20.05.2024.

Me 20.06.2024, OE AOME SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2024/0454, duke e atakuar Njoftimin për kontratë.

### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AOME SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti kontraktues (AK) ka shkelur Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) duke shkelur Nenin 1, i cili kërkon një procedurë të drejtë dhe transparente. Kriteret e kërkuara në tender, siç specifikohet në Nenin 7, nuk janë të barabarta dhe diskriminojnë operatorët ekonomikë (OE) që nuk plotësojnë kërkesat specifike, duke shpërfillur parimin e barazisë dhe jo-diskriminimit. Specifikimet teknike, sipas Nenit 28, janë diskriminuese; kërkesa për kamionë me kran të tonazhit 10 tonë është e papërgjegjshme dhe përjashton OE me kamionë me kapacitete më të ulëta, duke kufizuar konkurrencën. Për më tepër, Neni 51 është shkelur pasi kriteret e përzgjedhjes nuk janë proporcionale dhe relevante për lëndën e kontratës, duke favorizuar disa OE dhe kufizuar konkurrencën e lirë. Rregullorja Nr. 01/2022 për Prokurim Publik, në Nenin 11, kërkon që specifikimet teknike të sigurojnë konkurrencë të lirë dhe të mos kenë kufizime të panevojshme. Roli i Zyrës për Prokurim Publik (ZPP) është kritik për të siguruar që procedurat e prokurimit të jenë në përputhje me ligjin dhe rregullat përkatëse. Kërkohet që OSHP të shqyrtojë ankesën dhe të miratojë atë si të bazuar, duke kërkuar që AK të korrigjojë kriteret diskriminuese për të siguruar një procedurë konkurruese dhe të ndershme

Duke u referuar kërkesave si më sipër AOME SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1,7, 28 dhe 51 të LPP-së.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimet e parashtruesit kundërshtojnë kriteret e tenderit që kërkojnë kamiona me kran të tonazhit 10 tonë, duke i konsideruar këto kërkesa diskriminuese dhe jo të qarta për pronësinë e kamionëve dhe dokumentacionin e nevojshëm. Ai argumenton se këto kërkesa e përjashtojnë nga tenderi OE që kanë kamiona me kapacitete më të ulëta dhe se nuk ka specifikime të qarta për përdorimin e kamionëve me qira.

Megjithatë, parashtruesi nuk ka paraqitur prova që mbështesin pretendimet e tij. Sipas Rregullores për Prokurim Publik, është përgjegjësi e njësisë kërkuese të përgatisë dokumentacionin dhe specifikimet teknike, dhe ZPP ka marrë parasysh këto specifikime duke i dhënë besim procesit të përgatitjes së dokumenteve. Nëse AK ka paqartësi, mund të kërkojë informacione shtesë, dhe jo të kërkojë rishqyrtim për sqarime.

Për këto arsye, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar, duke u mbështetur në nenet përkatëse të Rregullores për Prokurim Publik

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 14.06.2024, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijë

Ankesa të aprovohet si e pa bazuar,

AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkojë me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Ankuesi nuk është pajtuar me raportin e cituar përderisa AK është pajtuar me raportin e ekspertit. Krahas kësaj konstatohet se palët janë të informuara reciprokisht lidhur me shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkritazi me ankesën.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave -***

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtruesit dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AOME SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0454 ka vlerësuar si në vijim: Pretendimi kryesor ankimor sipas ankesës 454/24 ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit për kamion me peshë bartëse 10+ ton. OE ankues pretendon se kjo është kërkesë diskriminuese dhe kërkon që të lejohet mundësia e ofertimit me pajisje kamion 5.5 ton. Pas analizimit të dosjes së tenderit dhe shkresave të lëndës, kemi kërkuar sqarime shtesë lidhur me këtë kërkesë. Më 14.06.2024 kemi pranuar përgjigje nga AK si në vijim: “Kërkesa në dosje të tenderit për kamion 10+ ton kupton një ngarkesë me 10 metra. Nëse e zvogëlojmë këtë në 5.5 ton, atëherë furnizimi do të vazhdojë me nga 5 metra, që do të thotë se për një shkollë duhet mbi 6 herë të ngarkohet me 5 metra. Unë nuk e shoh kërkesën 10 ton diçka jashtë normales, por sidoqoftë është vendosur si e arsyeshme.” Sqarimi i dhënë nga AK arsyeton kërkesën për kamion

10+ ton, pasi qëllimi është kryerja e furnizimit më efikas me sa më pak ndërprerje. Po ashtu, kamioni 10+ ton ngarkesë nuk është një pajisje ekskluzive që është vështirë e arritshme për OE-të. Për më tepër, kërkesa për kamion është që OE ta ketë në "posedim" dhe nuk është kërkuar që OE ta ketë në "pronësi", çka nënkupton se kamionët mund të merren me qira për realizimin e këtyre furnizimeve, duke paraqitur në ofertë dokumente si kontrata/marrëveshja për shfrytëzim të këtyre pajisjeve.

Bazuar në këto që u cekën më lart, eksperti shqyrtues ka vlerësuar pretendimet ankimore të OE ankues janë të pabazuara.

---

### *- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues pas analizës së provovave të paraqitura nga palët dhe raportit të ekspertit shqyrtues ra në konkludim se procedura e prokurimit e publikuar nga Autoriteti Kontraktues. Kuvendi i Komunës së Prishtinës, është zhvilluar në përputhje me LPP-në.

OE AOME SH.P.K., ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim, pas së cilës ka ndjekur një ankesë në OSHP me numër protokolli 2024/0454. Ankesa e tyre është bazuar kryesisht në pretendimet se Autoriteti Kontraktues ka bërë kërkesa diskriminuuese. Në përputhje me faktet dhe pretendimet e paraqitura, Paneli Shqyrtues ka arritur në përfundimin se ankesa e OE AOME SH.P.K. është e pabazuar. Kërkesa për kamion me peshë bartëse 10+ ton është konsideruar e arsyeshme dhe e nevojshme për të siguruar një furnizim më efikas dhe të pandërprerë, siç është sqaruar nga Autoriteti Kontraktues. Po ashtu, kërkesa për kamionët në "posedim" dhe jo në "pronësi" lejon mundësinë e qirasë, duke mos kufizuar padrejtësisht OE-të.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të lejoj Autoritetin Kontraktues -Kuvendi i Komunës së Prishtinës, të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me dru për institucionet edukativo arsimore, bashkësit lokale, bibliotekat, AMF-të dhe nevojat tjera komunale." me nr. të prokurimit: "616-24-4590-1-2-1".

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP -së për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " AOME " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: